

KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot më Datë 29 07 .2020, lidhet kjo Kontratë Dhurimi Kuotash ndërmjet palëve të mëposhtme:

Enklajd Malo, i biri i Muhametit, lindur më 13.10.1985 në Tiranë dhe banues po aty, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me Nr.Personal I51013044C,

Miranda Malo, e bija e Haxhiut, lindur më 08.02.1963 në Tiranë dhe banuese po aty, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e Pasaportës me Nr.BJ9192151 dhe Nr.Personal G35208204S,

Migena Malo, e bija e Muhametit, lindur më 13.10.1985 në Tiranë dhe banuese po aty, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e Pasaportës me Nr.BJ9237786 dhe Nr.Personal I56013027W,

Hauard Malo, i biri i Muhametit, lindur më 23.12.1995 në Tiranë dhe banues po aty, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me Nr.BB9441725 dhe Nr.Personal J51223047O,

I cili në vijim të kësaj Kontrate do të cilësohet si "Dhuruesit"

Dhe

Lorela Papushi, lindur më 28.07.1992 në Tiranë dhe banuese po aty, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e Letërnjoftimit me Nr.036237094 dhe Nr.Personal J25728065L,

E cila në vijim të kësaj Kontrate do të cilësohet si "Pranuesja e Dhurimit"

Deklarime Paraprake

Shoqëria "Met Change" Shpk, me NIPT L81316009V, është themeluar më Datë 08.01.2018, me Objekt Aktiviteti këmbime valutore, veprimtari e agjentit për transfertë parash në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jo bankë, shërbime të pagesave dhe të transferimit të parave në emër dhe llogari të një subjekti financiar jo bankë, veprimtari e Agjentit Komisioner, shërbime Unionet-Western Union. Selia e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga "Lekë Dukagjini", Pallati 11, Kati 2. Shoqëria ka një kapital të regjistruar prej 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) Lekë, i ndarë në 4 (katër) kuota. Ortakët e Shoqërisë dhe përqindjet e zotërimit të tyre në Kapital janë:

- Z.Enklajd Malo, zotërues i një kuote e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, me një vlerë prej 300,000 (treqind mijë) Lekë.
- Z.Hauard Malo, zotërues i një kuote e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, me një vlerë prej 300,000 (treqind mijë) Lekë.
- Znj.Miranda Malo, zotëruese e një kuote e cila përfaqëson 40% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, me një vlerë prej 600,000 (gjashtëqind mijë) Lekë,.
- Znj.Migena Malo, zotëruese e një kuote e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, me një vlerë prej 300,000 (treqind mijë) Lekë.



1

Përmes kësaj Kontrate, Dhuruesit shprehin vullnetin e tyre për t'i dhuruar kuotat që ata zotërojnë në Shoqëri, në favor të Pranuesit të Dhurimit.

Meqenëse ekzistojnë kushtet me sipër, palët bien dakord për sa me poshtë vijon:

NENI 1 **Objekti i Kontratës**

1.1 Objekti i kësaj Kontrate është kalimi i pronësisë përmes dhurimit, nga Dhuruesit në favor të Pranueses së Dhurimit të:

- Kuotës që Ortaku Enklajd Malo zotëron në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë "Met Change" Shpk, kuotë e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, me një vlerë 300,000 (treqind mijë) Lekë.
- Kuotës që Ortaku Huard Malo zotëron në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë "Met Change" Shpk, kuotë e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, me një vlerë 300,000 (treqind mijë) Lekë.
- Kuotës që Ortaku Migena Malo zotëron në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë "Met Change" Shpk, kuotë e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, me një vlerë 300,000 (treqind mijë) Lekë.
- Kuotës që Ortaku Miranda Malo zotëron në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë "Met Change" Shpk, kuotë e cila përfaqëson 40% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, me një vlerë 600,000 (gjashtëqind mijë) Lekë.

1.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Dhuruesit nuk zotërojnë më asnjë kuotë në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë "Met Change" Shpk.

1.3 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi i Dhurimit zotëron një kuotë e cila përfaqëson 100% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë "Met Change" Shpk.

NENI 2 **Transferimi i Pronësisë mbi Kuotat**

2.1 Pronësia mbi kuotat transferohet nga Dhuruesit te Pranuesja e Dhurimit me nënshkrimin e kësaj kontrate.

2.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Dhuruesit deklarojnë se nuk kanë dhe heqin dorë nga çdo pretendim kundrejt kuotave që ata zotëronin në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë "Met Change" Shpk.

2.3 Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rëndojnë mbi kuotat e zotëruara nga Dhuruesit në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate, transferohen te Pranuesja e Dhurimit.

NENI 3 **Baza ligjore dhe zgjidhja e moz marrëveshjeve**

3.1 Kjo kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi e konkretisht Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë dhe Ligji Nr. 99 01, Datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.



3.2 Mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre do jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 4
Të Ndryshme


4.1 Pas transferimit të kutoës së kapitalit tek Pranuesi i Dhurimit, ky i fundit behet pronar i ligjshëm i një kuote e cila përfaqëson 100% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, me një vlerë 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) Lekë, ndërsa Dhuruesit nuk kanë asnjë Kuotë në Shoqëri.

4.2 Pranuesi i Dhurimit ka detyrimin të depozitojë këtë Kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me qëllim për t'u reflektuar në ekstraktin e Shoqërisë, ndryshimet në rrethin e Ortakëve. Depozitimi i kësaj Kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit mund të bëhet menjëherë pas nënshkrimit të Kontratës.

PALET

DHURUESIT

Enklajd Malo



Hauard Malo



Migena Malo



Miranda Malo

Miranda Malo



PRANUESI I DHURIMIT

Lorela Papushi

Lorela Papushi

